

VENDIM
Nr. 228, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Armando Subashi.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të z. Armando Subashi, deputet i zonës zgjedhore, qarku Fier, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Koleji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues, për zonën zgjedhore, qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste, për zonën zgjedhore, qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013, ka fituar 9 mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste, për 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun Fier, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 10 është z. Anduel Xhindi.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste për qarkun Fier, kandidati i cili renditet me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) është z. Bujar Avdulla Çela. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se, personit të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Armando Subashi është z. Bujar Çelai, i cili është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 11 (dymbëdhjetë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Fier, z. Bujar Avdulla Çela.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.